

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A. B. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson av.N. Q., nga Prizreni, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës(KEK), të cilën e përfaqëson me autorizim Z. Sh., nga Prishtina, për shkak të anulimit të njoftimit, kontratës së punës dhe kthimit në vendin e punës përkitazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3372/2013 datë 8.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 01.09. 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet si i themeltë revizioni i paditësit, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.3372/2013 i dt.8.04.2016 , ashtu që mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.480/13 i dt.24.09.2013.

A r s y e t i m i

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3372/2013 të dt.8.04.2016 është pranuar ankesa e së paditurës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.480/13 i dt.24.09.2013, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të anulohet njoftimi i së paditurës për mos vazhdimin e kontratës nr..., dt..., dhe kontratës së punës nr..., dt..., si të kundërligjshme, të obligohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e tij të punës dhe ta sistemoj në pozitën referent i faturimit në Distriktin e Prizrenit dhe t'ia paguajë shpenzimet procedurale në lartësi prej 507€, të gjitha në afat prej 7

ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqit revizion paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, aktgjykimi i goditur të ndryshohet, ndërsa, aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet ose aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje Gjykatës së shkallës së dytë.

E paditura ka paraqitur përgjegje në revizion, me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni i paditësit është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura sipas kontratës së punës nr.11014 dt.1.02.2005, në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në vendin e punës referent i faturimit në Distriktin e Prizrenit. E paditura, paditësit ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës me vendimin e sajë nr..., dt.,, Për realizimin e mbrojtjes së të drejtave të veta, paditësi ka iniciuar procedurën kontestimore, në të cilën është marrë aktgjykimi i plotfuqishëm nga Gjykata Komunale në Prizren C.nr.887/07 dt.25.09.2008, i formës së prerë me dt.2.09.2009, me të cilin është anuluar vendimi i lartë cekur i së paditurës dhe është detyruar e paditura që paditësin t'a kthejë në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat që i takojnë sipas kontratës së punës nr..., të dt....Me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr.1837/09 dt.18.12.2009, është lejuar përmbarrimi i detyrueshëm i aktgjykimit të lartë përmendur dhe paditësi është kthyer në vendin punës, mirëpo edhe pse kthimi është bërë me dt.18.12.2009 e deri me dt.3.09.2010 ai ka mbetur i pa sistemuar dhe nuk i janë paguar të ardhurat personale. Paditësi ka kërkuar nga e paditura që t'a sistemojë në vendin e punës ashtu siç është përcaktuar në aktgjykimin e lartcekur të gjykatës. Pa marrë parasysh aktgjykimin e sipër cekur, e paditura, më pas, me shkresën nr..., dt..., e njofton paditësin se është sistemuar në vendin e punës specialist i daljeve në Distriktin e Pejës, ndaj të cilës shkresë paditësi paraqet ankesë me dt.17.08.2010 dhe

dt.18.08.2010,tek organet përkatëse të së paditurës, por nuk merr përgjegje. Me dt.3.09.2010 paditësi ka pranuar njoftimin nr.5726 se e paditura e ka caktuar në vendin e punës ku ka punuar, por, tani me kontratë të re nr...,me afat të caktuar për tre muaj me mundësi vazhdimi.(pavarësisht kontratës së parë në kohë të pacaktuar të dt.1.02.2005),të cilën edhe pse e ka nënshkruar, paditësi e ka kundërshtuar me shkrim dhe i është drejtuar organeve kompetente të së paditurës, por, pa marrë përgjigje. Ndërkohë që, me dt.7.12.2010,nëpërmjet njoftimit të së paditurës, është njoftuar se i është shkëputur marrëdhënia e punës, për shkak të skadimit të kohëzgjatjes, e cila sipas kontratës së dt.1.09.2010 ishte për tre muaj.

Në bazë të kësaj gjendjeje faktike të vërtetuar , gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka pranuar ankesën e së paditurës, ka vlerësuar se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i papranueshëm sepse e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar ,ndaj, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë ,ashtu që, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të sajë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e këtyre të çështjes juridiko-civile, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejt dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike, por, në bazë të kësaj gjendjeje faktike, gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, për çfarë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet, ashtu që të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Vlerësimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë se kontrata e punës nr..., dt..., midis paditësit dhe së paditurës, ka qenë e lidhur në kohë të caktuar dhe atë për periudhën kohore nga 1.09.2010 e deri 31.11.2010 dhe se paditësit me skadimin e afatit të kontratës i ka pushuar marrëdhënia e punës, konform nenit 11.1p.d)të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rreg.UNMIK-ut nr.2001/27,respektivisht nenit 26 të LMD-ës. Se çdoherë është në vullnetin e lirë të palëve që të vendosin se a do të vazhdohet apo jo një kontratë të cilës i ka skaduar afati, me çka në rastin konkret nuk ka qenë në interesin e së paditurës që të vazhdon kontratën e punës me paditësin apo që me të njëjtin të lidh kontratë të re, për Gjykatën Supreme të Kosovës është i pabazuar, i papranueshëm dhe i kundërligjshëm.

Në kontekstin e mësipërm, parashtrohet pyetja se qfarë u bë me kontratën nr..., të dt..., e cila po ashtu ishte e lidhur midis paditësit dhe së paditurës, por kjo, ishte lidhur për kohë të pacaktuar, ndërkohë që, nga shkresat e lëndës rezulton se kjo kontratë ka mbetur në fuqi, është e vlefshme dhe nuk është anuluar deri tani me ndonjë vendim të formës së prerë të ndonjë organi kompetent (shih në dosjen e lëndës edhe aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.887/07 dt.25.09.2008 dhe dispozitivin e tijë). Kjo Gjykatë konsideron se, kontrata e punës nr..., dt..., dhe njoftimi i së paditurës nr..., i dt..., mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës së paditësit, janë të kundërligjshme. Nga shkresat e kësaj lënde, rrjedh se, parashtrës, kundërshtimet, ankesat e paditësit ndaj veprimeve të së paditurës, nuk kanë marrë përgjigje nga organet e së paditurës, ajo nuk ka dhënë shpjegimet a arsyet përkatëse për veprimet e veta, ato, nuk shihet se janë trajtuar si duhet nga e paditura. Prandaj, edhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë, përkitazi me njoftimin dhe kontratën e sipërcekur, është jo i drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 2,3,4 të Ligjit Kundër Diskriminimit (Ligji nr.2004/3), nenit 2 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rreg.UNMIK-ut 2001/27. Me dispozitën e nenit 49 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, "E drejta e punës garantohet". Me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 3,31,32,54 etj) dhe me dispozitat përkatëse të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut garantohet barazia para Ligjit. Me dispozitat e nenit 4 të Ligjit Kundër Diskriminimit, parashihet se ky ligj zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë edhe organet publike të cilat cenojnë të drejtat e personit fizik dhe juridik në fushat vijuese: si në aspektin e kushteve për çasje në punësim, vetëpunësim, kushtet e punësimit, kushtet e punës, shkarkimin nga puna, pagesën etj. Ndërsa, me dispozitat e nenit 3 të të njëjtit Ligj parashihet ndalimi i diskriminimit dhe llojet e diskriminimit, kurse në pikën e) të kë tije neni parashihet: "Viktimizimi konsiderohet diskriminim brenda kuptimit të nenit 2a dhe i cili konsiderohet se ndodh kur personi përjeton trajtim të hidhur apo pasoja të hidhura si reagim ndaj ankimit apo procedurës, të vëna në lëvizje me qëllim të vënies në jetë të parimit të trajtimit të barabartë ashtu siç është definuar në nën 2a dhe /ose rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë tjetër në lidhje me ankesën ose procedurën". Poashtu, edhe me dispozitat e nenit 2 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë (Rreg.UNMIK-ut 2001/27) ishte paraparë "Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit", sikundër, edhe me nenin 5 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës.

Në prani të këtyre fakteve juridike dhe nga arsyet e sipërpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet në revizion se gjykata e shkallës së dytë e ka zbatuar

gabimisht të drejtën materiale, kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, prandaj, e ndryshojë aktgjykimin e sajë dhe vendosi t'a lë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë.

Nga sa u theksua më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.197/2016 datë 1. 09. 2016

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha

